



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Zyra e Personelit

Nr.01/

567

Më:13.07.2021

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit për Zyrarët Publik Nr. 06/L-114, Komuna e Malishevës shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Vozitës për nevojat e Administratës

Institucioni: Komuna e Malishevës

Departamenti/ Drejtoria: Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Numri i pozitave: (1) Një

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme

Grada/Koeficienti: 5

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publik:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje
- Të mos ketë në fuqi ndonjë masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas ligjit.

Detyrat dhe përgjegjësitë për Vozitësit

- Drejton automjetin sipas urdhrit të mbikëqyrësit, si dhe kujdeset për automjetin me të cilin është i ngarkuar;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e tij, larjen, lyerjen, evidentimin e prishjeve etj;
- Mirëmban edhe automjetet e tjera sipas orarit të punës përmes mbikëqyrësit të tijë;
- Përgjigjet për automjetin dhe pajimet e automjetit;
- Në fletudhëtim regjistron numrin e kilometrave të kaluara në udhëtim, dhe shënimet tjera të cilat kërkohen;
- Paraqet mbikëqyrësit të tij, çdo defekt dhe dëme të shkaktuar në automjet, dhe bën arsyetimin e shpenzimeve të derivateve dhe kilometrazhit të kaluar;
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrit të mbikëqyrësit dhe drejtorit të drejtorisë;
- Për punën e vet i përgjigjet mbikëqyrësit drejtorit të drejtorisë DAP.

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

- Njohja dhe përvoja e duhur profesionale
- Të ketë diplomën e shkollës së mesme.
- Të ketë të kryer kategorinë "B"- të patentë shoferit
- Të ketë gatishmëri të punoj në të gjitha grupet, pa dallim: moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni apo race.
- E preferueshme përvoja punës.

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit i plotësuar
- Dokumenti personal (Letërnjoftimi apo Pasaporta), fotokopje
- Diploma e shkollës së mesme
- Kopjet e patentë shoferit
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (Originali)
- Certifikata e Mjekut (pas përzgjedhjes nga Komisioni)

Dokumentet duhet të jenë në Kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen në rastin e intervistimit.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat do të jenë të dëshmuara (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

30 ditë nga dita e publikimit të konkursit mbetet vetëm njoftim, ndërsa konkursi mbetet i hapur 15 ditë, aplikacionet dorëzohen nga data 14.08.2021 deri më 27.08.2021 (16:00).

Paraqitja e kërkesave:

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këtë vend të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në Zyrën për pritjen e palëve KK- Malishevë, si dhe mund të shkarkohen nga ueb-faqja zyrtare e Komunës së Malishevës, dhe të plotësuara dorëzohen në zyrën e pranimit.

Konkursi është i shpallur në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/> , si dhe në faqen e Komunës së Malishevës.

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.
- Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Udhëheqësi i Personelit
Gani Bahitjari, jur. dipl.

